

# REZOLUTË

## RILINDJA E KOMUNITETEVE RURALE PËRMES JETËSIMIT TË QASJES LEADER NË SHQIPËRI

*Akademia e zhvillimit të integruar vendor "LEADER" – domosdoshmëri për të garantuar suksesin e zbatimit të zhvillimit vendor të udhëhequr nga komuniteti.*

*Tridhjetë organizatat anëtare të Asamblesë së Përgjithshme të Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural*

**Duke marë në konsideratë** miratimin e Ligjit Nr. 36/2022 "Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit", i cili lehtëson zbatimin e zhvillimit vendor të udhëhequr nga komuniteti – instrumenti i politikës së përbashkët evropiane për zhvillimin e integruar rural, i njohur ndryshe si qasja Leader. ANRD në komunikim të vazhdueshëm me aktorë të ndryshëm ka konstatuar se miratimi i Ligjit ka nxitur lidhshërinë e OSHC-ve lokale dhe bashkive në nisma me orientim nga poshtë për ngritjen e GVV-ve dhe hartimin e strategjive lokale të zhvillimit si një mënyrë për fuqizimin e komuniteteve lokale dhe orientimin e tyre drejt një zhvillimi të integruar;

**Janë entuziaste** për momentumin që krijon programi IPARD III për të angazhuar vullnet politik dhe për të mbështetur dhe priorizuar zbatimin e qasjes Leader - si histori suksesi e politikës së përbashkët evropiane bujqësore. Masa 5 e Programit, *Zbatimi i strategjive lokale të zhvillimit – qasja Leader* do të mbështesë në vlerën 4.8 milion Euro këtë qasje duke mundësuar kështu zhvillimin lokal të udhëhequr nga komuniteti si dhe duke u frymëzuar nga historia e suksesshme e zbatimit të qasjes Leader në Evropë;

**Risjellin në vëmendje** një nga kërkesat e Deklaratës së Përbashkët të Parlamentit të dytë Rural Shqiptar (4-5 mars 2021) *...Ne kërkojmë vullnet politik për të priorizuar dhe mbështetur këtë instrument (LEADER) si dhe përshpjegimin e zbatimit efektiv të tij si një faktor thelbësor për përmirësimin e cilësisë së jetës për komunitetet rurale në Shqipëri, vecanërisht në parandalimin e shpopullimit dhe braktisjes së zonave rurale.*

**Ndërsa përgëzojnë** Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për frymën e bashkëpunimit që ka krijuar me aktorët jo-publikë në konsultimin dhe krijimin e bazës nënligjore për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit dhe *angazhohet* për të kontribuar në procese që ndihmojnë zbatimin e qasjes Leader;

**Duke pranuar** se qasja Leader nuk është fare e panjohur për zhvillimin lokal në Shqipëri falë mbështetjes së nismave komunitare të llojit Leader nga donatorët ndërkombëtarë që në fillim të viteve 2000. E megjithatë, pavarësisht kësaj, për faktin që ato nuk u shoqëruan me mbështetje të vazhdueshme për të siguruar qëndrueshmërinë e strukturave të partneritetit të krijuar, Leader-i nuk u kthye në instrument që do të mund të ndihmonte fshatin dhe komunitetet rurale të përballonin problemet (shpopullimi, menaxhimi i burimeve natyrore, varfëria, pabarazitë zhvillimore, pabarazia gjinore, kapitali i ulët social) që politikatat publike nuk i adresuan efektivisht si dhe duke shprehur shqetësimin për mundësitë të humbura më herët për një sipërmarrje të mundshme kombëtare në zbatimin e qasjes Leader, të nxitur nga nisma të mëhershme qeveritare, sic është Programi i 100 fshatrave;

**Shprehin bindjen** se Leader ka potencialin të shndërrohet në politikën publike që deri më tani i ka munguar zhvillimit të qëndrueshëm, duke mbështetur të gjitha politikat e tjera në fushën e punësimit, barazisë gjinore, migracionit, turizmit, mjedisit, infrastrukturës vendore publike, zhvillimit rajonal etj, sepse krijon incentivat e duhura për aktorët vendorë, veçanërisht grupet e cënueshme të shoqërisë (gratë, të rinjtë, fermerët e vegjël, minoritetet, të papunët, banorët e zonave malore etj) për të qëndruar, jetuar dhe punuar në fshatin e tyre;

**Duke u mbështetur** në rolin e rëndësishëm të Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural si dhe përvojën, kapacitetet dhe potencialin për të kontribuar në zbatimin e sukseshëm të qasjes Leader: platforma të rrjetëzimit, pika kontakti në të gjitha nivelet, hapësira diskutimi dhe ndërtimi të kapaciteteve, burime njerëzore të trajnuara, ekip i çertifikuar për qasjen LEADER, materiale ndërgjegjësuese dhe nisma advokacie janë të disponueshme për të ndihmuar zbatimin e qasjes, veçanërisht në lidhje me proceset e animimit të aktorëve dhe përvetësimin e aftësive. Vetë struktura organizative e ANRD krijon hapësirë për anëtarësimin dhe rrjetëzimin e GLV-ve;

**Të bindur** se procesi i animimit territorial në nivel vendor për ngritjen e partneriteteve tripalëshe ka nevojë të inkurajohet dhe mbështetet është jetike komplementariteti i përpjekjeve të Ministrisë me kapacitetet dhe potencialin që ofron ANRD, si një rrjet kombëtar i ngritur bazuar në vet parimet e qasjes Leader. Bashkëpunimi ndërmjet MBZHR dhe ANRD do të lehtësojë krijimin e modeleve dhe praktikave pozitive në zhvillimin e udhëhequr nga komuniteti, përmes përgatitjes së terrenit të duhur për zbatimin efektiv të ligjit dhe si rrjedhim të filozofizë evropiane Leader për zhvillimin e integruar vendor. ANRD shpreh gadishmërinë në organizimin e ëorkshopeve udhëtuese në këto GVV duke angazhuar aktorët relevant të angazhuar në nivele të ndryshme: anëtarë të Komisionit Parlamentar për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, stafin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të Agjensisë së Zhvillimit Bujqësor, bashkive të vendit, organizatave të shoqërisë civile, sektorit privat dhe sipërmarrjes, medias, akademisë dhe të tjerë ekspertë, profesionistë dhe entuziastë të zhvillimit rural;

**Kërkojnë** Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të luajë rolin e vet katalizues në mobilizimin e asistencës nga donatorë të ndryshëm për të përgatitur terrenin e duhur për zbatimin e qasjes, duke përfshirë informimin, ndërtimin e kapaciteteve të gjithë aktorëve të interesit, asistencën teknike dhe infrastrukturën e duhur që mbështet zbatimin e suksesshëm të qasjes Leader, duke përfshirë zbatimin efektiv të ligjit dhe rrjedhimisht masës Leader të përfshirë në IPARD III. Procese të hapura, transparente dhe gjithëpërfshirëse që lehtësojnë shkëmbimin e informacionit dhe koordinojnë aktorët të angazhuar në nivele të ndryshme në mënyrë të vazhdueshme;

**Propozojnë dhe angazhohen** për të krijuar Akademinë e Zhvillimit të Integruar vendor "LEADER" si qendër burimore për filozofinë e zhvillimit vendor të udhëhequr nga komuniteti. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ftohet të angazhohet bashkërisht në realizimin e Akademisë duke bashkëpunuar dhe koordinuar me donatorë të përfshirë në mbështetjen e sektorit rural dhe bujqësor. Akademia do të përfshijë module trajnimi mbi ngritjen e kapaciteteve për aktorët e interesit (Njësitë e vetqeverisjes vendore dhe institucione të tjera publike, organizatat e shoqërisë civile, sipërmarrjen dhe sektorin e biznesit etj), ëorkshope tematike, asistencë teknike për zhvillimin e strategjive të zhvillimit lokal, projekteve, dhe aktivitete të tjera shkëmbyese dhe rrjetëzuese për Leader. Ekspertë nga vende të tjera evropiane, si nga Italia, Sllovenia dhe Kroacia mund të jenë pjesë e Akademisë për të sjellë njohuri dhe përvojën e këtyre vendeve në zbatimin e këtij instrumenti të zhvillimit vendor.